

МРЕЖА

23




MULTIKULTURA

Ndihma juridike pa pagesë - sfidat dhe zgjidhjet

Projekti financohet nga BE 

Multikultura, Tetovë, 2017



Publikimi është pjesë e projektit “Ndihma juridike pa pagesë – sfidat dhe zgjidhjet”, e përpiluar nga ana e Shoqatës Multikultura – Tetovë.

Kjo analizë është mundësuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të projektit të Mrezha 23+ të cilin e implementon Instituti për Politikë Evropiane (EPI) – Shkup dhe Komiteti i Hesinkit për të drejtat e njeriut.

Mendimet e dhëna në këtë publikim janë mendimet e autorëve dhe jo gjithmonë shprehin mendimet dhe politikat e Bashkimit Evropian.

Të gjithë të drejtat për sa i përket publikimit i takojnë Shoqatës Multikultura – Tetovë.

Ndihma juridike pa pagesë – sfidat dhe zgjidhjet

Përmbajtja

Shkurtesat e shfrytëzuara.....	5
Parathënie	6
HYRJE	7
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	8
Fushat e selektuara.....	8
Ligji për ndihmë juridike pa pagesë.....	9
Sjellja e Ligjit për ndihmë juridike pa pagesë	9
Çështjet juridike për të cilat miratohet ndihma juridike pa pagesë.....	10
Dhënësit e ndihmës juridike pa pagesë.....	10
Kushtet për fitimin e të drejtës për ndihmë juridike pa pagesë.....	10
Procedura e realizimit të ndihmës juridike pa pagesë	11
Të dhënat statistike të realizimit të ndihmës juridike pa pagesë.....	11
TË DHËNAT STATISTIKE TË VENDIMEVE TË LËSHUARA.....	12
Finansimi i ndihmës juridike pa pagesë.....	14
Përfundimet kryesore të dala nga realizimi i anketës së realizuar për njohjen e qytetarëve me LNJP-në, me kushtet dhe të drejtat e shfrytëzimit të këtij ligji në qytetin e Tetovës.....	14
Rekomandimet e dala nga anketa e realizuar për njohje të NJP-së dhe kushteve e procedurave për shfrytëzimin e saj në qytetin e Tetovës.....	16
Përfundimet e dala nga target grupi i shoqatave të regjistruara për të dhënë ndihmë juridike paraprake.....	17
Literatura e shfrytëzuar	19
Aneks 1	20

Shkurtesat e shfrytëzuara

NJPP – Ndihma juridike pa pagesë

LNJPP – Ligji për Ndhmë juridike pa pagesë

BE – Bashkimi Evropian

PSR – Plani strategjik për reforma

MD – Ministria e drejtësisë

NjR – Njësia rajonale

RM – Republika e Maqedonisë



Parathënie

Atje ku drejtësia mungon, varfëria sundon, padituria mbisundon dhe një shtresë e caktuar ndien se shoqëria është e organizuar me propagandë që shkakton presion, vjedh dhe i degradon njerëzit, asnjë njeri dhe asnjë pronë nuk është plotësisht e sigurt.

Frederik Dagllas, prill, 1886

Kanë kaluar 8 vjet nga implementimi i Ligjit për ndihmë juridike pa pagesë, por megjithatë ende ka dilema se sa është efektiv ky ligj dhe sa nga qytetarët e shfrytëzojnë të drejtën e këtij ligji.

Me shpresë se kjo analizë do të jetë burim informacionesh për qytetarët dhe opinionin e gjerë, jemi munduar të sjellim material që do të jetë në pajtueshmëri me kohën dhe ndryshimet e LNJPP dhe të akteve të tjera të dobishme në shtet. Në këtë hulumtim, janë shtruar disa pyetje themelore të cilat kërkojnë përgjigje sepse synojnë analizimin dhe dobinë e informacioneve për qytetarët dhe të drejtën e tyre për shfrytëzimin e këtij ligji. Problemet me të cilat ndeshen qytetarët gjatë zbatimit të të drejtës për Ndihmë juridike pa pagesë dhe udhëzimet rreth kapërcimit të atyre problemeve, janë qëllimi parësor i kësaj analize. Të dhënat e dala nga ky hulumtim janë fituar nga anketimi me qytetarët e Tetovës dhe nga intervistat e realizuara me organizata të tjera të legjitimuara për të dhënë NJP.

Përmes këtyre mjeteve, jemi munduar t’i identifikojmë problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët gjatëshfrytëzimit të këtij ligji, me theks të veçantë në qytetin e Tetovës, si dhe jemi munduar të gjejmë zgjidhje për këto probleme dhe sfida. Gjithashtu, jemi munduar që të informojmë qytetarët për përmbajtjen e këtij ligji dhe për mënyrën se si ta shfrytëzojnë të njëjtin.

Me respekt,

M-r Vullnet Zenki

Drejtor Ekzekutiv

Shoqata Multikultura

HYRJE

Ligji për ndihmë juridike pa pagesë është përshtatur si pjesë e planit strategjik për reforma në sistemin e gjyqësorit, me qëllim harmonizimin e ligjeve dhe akteve të tjera juridike të shteteve të UE-së.

LNJP u përpilua në dhjetor të vitit 2009, ndërsa filloi të zbatohet në korrik të vitit 2010. Në fillim të implemenitimit, numri i kërkesave për NJP ishte shumë i vogël sepse njerëzit ende nuk kishin informacion për mundësitë e shfrytëzimit të të drejtës për NJP, madje sipas anketës së realizuar nga organizata Multikultura edhe sot një numër i vogël qytetarësh ka informacion për këtë ligj dhe atë pjesa më e madhe janë njerëz që i takojnë sferës juridike.

Si shkak kryesor i mosinformimit të qytetarëve për këtë ligj, është mungesa e promovimit të këtij ligji, për arsye të panjohura. Prandaj, është e nevojshme që të bëhet një promovim për ekzistencën e këtij ligji nga Ministria e Drejtësisë në ueb-faqet e ministrisë, me të gjitha detajet e përmbajtjes së këtij ligji, në formë të shkruar. Vetëm në këtë formë, besojmë se do të mund të informoheshin qytetarët për Ligjin e ndihmës juridike pa pagesë.



METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Ky hulumtim do të fokusohet në kërkesën e LNJP që nga lëshimi i tij deri në vitin 2016, duke i krahasuar të dhënat nga raportet e Ministrisë së Drejtësisë dhe nga organizatat e tjera që japin ndihmë juridike pa pagesë.

Përfshirja kohore e këtij hulumtimi është 01.01.2016 deri më 31.12.2016. Në hulumtim të përpiktë për kërkesën e ligjit dhe për të dhënat statistike, kemi ardhur përmes anketave me qytetarët dhe intervistave me ekspertë të fushës së drejtësisë. Numri i anketimeve arrin deri në 500 të anketuar me vendbanim në Tetovë, prej të cilëve 51% ishin të gjinisë femërore ndërsa 49% të gjinisë mashkullore, me tri kategori grupmoshash: 31% përfaqësues të moshës 16-25, 46% moshë 26-35 dhe 23% mbi 36 vjet.



Gjithashtu, janë intervistuar edhe katër organizata të Republikës së Maqedonisë, të cilat janë të legjitimuara për dhënie të NJPP: CRJZH, ROMA SOS, NRC KUMANOVO dhe Organizata e juristëve të rinj të Maqedonisë. Në këto takime u bisedua për numrin e kërkesave dhe për miratimin e tyre. Poashtu u diskutua edhe mundësia e promovimit të këtyre shërbimeve para qytetarëve.

Edhe përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë në rajonin e Tetovës, janë intervistuar me qëllim që të fitohet pasqyrë reale për numrin e kërkesave të parashtruara për NJP dhe për numrin e miratimit të po të njëjtave. Gjatë këtyre takimeve, mësuam se cilat janë kushtet që në përvojat e tyre kanë rezultuar me kërkesa të miratuara me sukses, si dhe cilat janë gabimet e qytetarëve që më pas si rrjedhojë pasohen nga refuzimi i kërkesave për NJP. U diskutua edhe për ndryshimet që janë të nevojshme të bëhen në Ligjin për ndihmë juridike pa pagesë dhe për përfitimet që do të kemi ne si organizata duke fituar sa më shumë lëndë. Këto takime janë realizuar nën udhëheqësinë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë në qytetin e Tetovës.

Fushat e selektuara

Me këtë hulumtim do të përpiqemi të japim të dhëna të detajuara për secilën nga fushat e selektuara, si p.sh.:

- Numri i kërkesave të parashtruara për NJP:

- Sa kërkesa janë bërë në zona të caktuara? A janë numër I madh ose jo, a janë më shumë ose më pak krahasuar me raportin e vitit 2015, ka dallime nga qyteti në qytet në raport me kërkesat e parashtruara?
- Numri I kërkesave të pranuar dhe I atyre të refuzuara: cilët ishin vendimet e ministrisë për kërkesat dhe cilat ishin shkaqet e mospranimit të të njëjtave?
- Për çfarë problemesh janë parashtruar kërkesa për NJP më së shumti? A janë të rregulluara me ligj numri më i madh i pyetjeve për të cilat mund të sigurohet NJP dhe për cilat çështje juridike ka më tepër kërkesa? A duhet të miratohen kërkesat edhe për ato pika që nuk janë të parapara nëligj?
- A janë të përfshirë ata që kanë nevojë për NJP dhe kushtet për shfrytëzimin e ndihmës a janë lehtësisht të realizueshme?
- Meqenëse në ligj, ka prioritet procedura e NJP-së, do të mundohemi të kuptojmë sa është efikase dhe sa është e sigurt proceduura e NJP-së?
- A ka mundësi që personat të cilëve u është refuzuar kërkesa, të dorëzojnë mjetet juridike
- Roli I dhënësve të NJP-së
- Financimi I NJP-së, mjetet e parapara dhe nevojat për të qenë më të mëdha financat nga Ministria e Drejtësisë për këto problematika.

Ligji për ndihmë juridike pa pagesë

Sjellja e Ligjit për ndihmë juridike pa pagesë

Republika e Maqedonisë, për të fituar të drejtën e plotë për anëtarësim në Unionin Evropian, është e obliguar që të bëjë harmonizimin e legjislacionit shtetëror me aktet ndërkombëtare, me qëllim që qytetarët të kenë qasje në ndihmën juridike pa pagesë dhe në sistemin e drejtësisë.

Ligji për Ndihmë Juridike pa Pagesë, është inkuadruar në agjendën e Qeverisë së RM si strategji për ndryshime në sistemin e gjyqësorit dhe ndryshimeve në legjislacion.

Pra, LNJP u lëshua në dhjetor të 2009, prandaj risia që ky ligj e kishte paraparë, kërkonte rreth 6 muaj kohë për të qenë e mundur të implementohet (në korrik të 2010). Gjatë këtyre 8 vjetëve, ligji ka pësuar tri here ndryshime në disa pika jothemelore.

Ndryshimi I ligjit I bërë më 2011, përfshinte pjesën e e zgjerimit të kategorisë së shfrytëzuesve të kësaj ndihme. Ndryshimet e vitit 2014 lidheshin me harmonizimin e LNJP me Ligjin për drejtësi të fëmijëve, ndërsa ndryshimi I fundit ishte për lidhjen e Ministrisë së Drejtësisë mesistemin e Agjencionit të patundshmërive



Si një nga detyrat e ministrisë, ligji parasheh (neni 35) përgatitjen e një raporti që do të përmbajë informacion për strukturat ligjore, të dhënat statistike, numrin e kërkesave, numrin e vendimeve, çështjet për të cilat kërkohet më së shpeshti ndihma, dhënësit e ndihmës dhe vëllimin e mjeteve financiare për kërkesat e miratuara dhe të mjeteve të kthyera.

Çështjet juridike për të cilat miratohet ndihma juridike pa pagesë

NJP miratohet në të gjitha procedurat gjyqësore, për aq kohë sa jep zgjidhje për çështje me interes për kërkuesin e të drejtës juridike në fushën e sigurimit shëndetësor, social, invalidor dhe sigurimit të pensionit. Poashtu edhe për marrëdhëniet e punës, mbrojtjen e fëmijëve, viktimat e dhunës familjare, mbrojtjen e viktimave nga ndëshkimet penale, mbrojtjen e viktimave të tregtisë me njerëz, njohjen e të drejtës për azil dhe çështjet që lidhen me të drejtat e pronës private.

Dhënësit e ndihmës juridike pa pagesë

Në pajtueshmëri me ligjin, NJP realizohet si ndihmë juridike e mëparshme pa pagesë dhe si ndihmë juridike në procedura drejtuese e gjyqësore. Në dhënien e ndihmës së mëparshme juridike janë të kyçura departamente rajonale të Ministrisë së Drejtësisë dhe organizata të autorizuara.

Kushtet për fitimin e të drejtës për ndihmë juridike pa pagesë

Kushtet që duhet të plotësohen, për të qenë e miratuar ndihma juridike pa pagesë janë të parapara me nenin 12 të LNJP-së. Pika (1) e këtij neni parasheh:

- (1) Të drejtë për NJP kanë personat e përmendur në pikën 2 të këtij neni, duke pasur parasysh gjendjen e tyre financiare të rënduar e cila ua pamundëson që të realizojnë të drejtat e tyre statutore, pa cenuar mirëqenien e tyre dhe të familjeve ku jetojnë.

Pika (2) e këtij neni, parasheh këto kategori njerëzish të cilët mund ta fitojnë të drejtën për NJP, me kusht që të jenë qytetarë dhe banorë të përhershëm të RM, edhe atë:

- Fëmijë të rrezikuar
- Fëmijë për të cilët dyshohet se kanë kryer vepra penale apo shkelje të ligjit
- Shfrytëzues të ndihmës sociale
- Shfrytëzues të ndihmës së paraparë për invalidë, të cilët nuk kanë të ardhura e as pasuri të patundshme.

- Shfrytëzues të pensioneve të ulëta që jetojnë në familje me dy ose më tepër familjarë të varur nga të ardhurat e vetme të pensionit.
- Familje ose prindër me një apo më shumë fëmijë të cilët gëzojnë të drejtat e shtesës fëmijërore.

Pika (3) e këtij neni, parasheh që krahas kategorive të lartpërmendura, përkatësisht në pikën (2), të drejtën e NJP-së e kanë edhe:

- Kërkuesit e azilit, të zhvendosurit brenda vendit si dhe të dëbuarit e të përndjekurit që kanë vendbanim në RM,
- Shtetasit e huaj, të cilët në pajtueshmëri me marrëveshjet ndërkombëtare kanë vendqëndrim dhe vendbanim në RM, me dhënie të së drejtës nga organet kompetente të RM
- Persona pa nënshtetësi por të cilët ligjërisht qëndrojnë në RM.

Më tej, në nenin 14 të ligjit, ligjvënësi ka paraparë diferencime, përkatësisht kufizime të cilat përfshijnë pronësinë dhe numrin e anëtarëve me të cilët jeton në bashkësi, kërkuesi i ndihmës juridike pa pagesë. Gjegjësisht, është e paraparë që:

Ndihma juridike pa pagesë nuk mund të miratohet nëse kërkuesi i së njëjtës, ose ndonjë anëtar nga familja në të cilën jetojnë në bashkësi, ka pronë e cila arrin ose tejkalon pesë rroga bruto mujore, mesatare të paguara në RM, gjatë muajit paraprak.

Proceduara e realizimit të ndihmës juridike pa pagesë

Kërkesa për ndihmë juridike pa pagesë, bëhet personalisht ose nëpërmjet postës në departamentet përkatëse të ministrisë në një udhëzues të shkruar tek i cili bashkëngjitet edhe njëdeklarata për gjendjen financiare të kërkuesit të ndihmës, por edhe të gjendjes së familjes dhe anëtarëve të saj bashkë me të gjitha të dhënat e tyre dhe të pronësisë së poseduar. Pas kërkesës, vendimine miratimit ose të refuzimit e merr Ministria e Drejtësisë, vendim kundër të cilit mund të bëhet ankesë, në rast pakënaqësie.

Të dhënat statistike të realizimit të ndihmës juridike pa pagesë

Kërkesat për ndihmë juridike pa pagesë, të bëra gjatë vitit 2015 në pajtueshmëri me ligjin. (raporti i fundit nga Ministria e Drejtësisë).





Njësia rajonale	Numri i kërkesave të dorëzuara
1. Berovë	22
2. Manastir	91
3. Makedonski Brod	10
4. Vinicë	1
5. Vallandovë	12
6. Gjevgjeli	16
7. Gostivar	0
8. Dibër	2
9. Dellçevë	2
10. Demir Hisar	2
11. Kavadar	38
12. Kërçovë	44
13. Koçan	7
14. Kratovë	37
15. Kriva Pallankë	16
16. Krushevë	3
17. Kumanova	119
18. Negotina	30
19. Ohri	12
20. Prilep	9
21. Probishtip	12
22. Radovish	39
23. Prespa	9
24. Sveti Nikollë	1
25. Strugë	5
26. Strumicë	49
27. Tetovë	68
28. Veles	4
29. Shtip	45
30. Karposh	22
31. Komuna Qendër	19
32. Kisella Vodë	39
33. Gazi Babë	57
34. Cair	21
35. Direkt në MD	49
Gjithësej	912

TË DHËNAT STATISTIKE TË VENDIMEVE TË LËSHUARA

<i>Viti</i>	<i>Kërkesa të dorëzuara</i>	<i>Vendime të marra</i>	<i>Kërkesa të miratuara</i>	<i>Kërkesa të refuzuara</i>	<i>Procedura të ndalura</i>
	2	3	4	5	6
1 <i>2010/2011</i> <i>(oð 07.07.2010- ðo 24.03.201)</i>					
<i>2011/2012</i> <i>(oð 25.03.2012ðo 31.03.2012)</i>	118	74	29	42	3
<i>2012/2013</i> <i>(oð 01.04.2012- ðo 31.03.2013)</i>					
<i>2013/2014 (oð 31.03.2013- ðo 31.12.2014)</i>					
<i>2015</i> <i>(oð 01.01.2015- ðo 31.12.2015)</i>	154	172	64	91	17
Gjithësej	180	196	68	126	2
	254	254	114	140	4
	192	192	113	79	7
	898	888	388	478	33



Numri më i madh i kërkesave të miratuara, përfshijnë çështjet e të drejtave të pronësisë së viktimave të dhunës familjare dhe të fëmijëve të pambrojtur, përderisa fushat e tjera si ndihma sociale, pensioni, sigurimi shëndetësor dhe marrëdhëniet e punës janë më pak të përfaqësuara.

Finansimi i ndihmës juridike pa pagesë

Mjetet e financimit të NJP, sigurohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, si program i veçantë i propozuar nga ana e ministrit dhe i miratuar nga qeveria e RM, por edhe nga donacionet dhe burimet e tjera të cilat janë në pajtueshmëri me ligjin. Këto mjete janë të parapara për shpërblimin e avokatëve si dhe për mbulimin e shpenzimeve të organizatave të autorizuara për ndihmë juridike pa pagesë ndaj rasteve të miratuara si fitues të së drejtës për shfrytëzimin e ndihmës. Këto mjete nuk mbulojnë harxhimet e sistemit të NJP-së (burimet njerëzore, infrastrukturën, promovimin).

Shpenzimet e dala nga dhënia e NJP-së i mbulon shteti, por ky buxhet në të ardhmen duhet të zmadhohet me qëllim që të jetë i mundur miratimi i edhe më shumë kërkesave. Në vend që të shkurtohet buxheti, duhet që po i njëjti të shfrytëzohet në promovimin e ligjit, me qëllim që të informohet popullata, por edhe të shfrytëzohet nga organizatat e autorizuara për ndihmë juridike paraprake, për regjistrin e avokatëve, për kushtet dhe mirëmbajtjen e një ueb-faqeje të posaçme për NJP ku do të jepen të dheëna të sakta dhe sqarime për pyetjet që i parashtrijnë qytetarët, me qëllim që të shmangen edhe harxhimet e tyre që mund të kenë gjatë parashtrimit të kërkesës për NJP.

Përfundimet kryesore të dala nga realizimi i anketës së realizuar për njohjen e qytetarëve me LNJP-në, me kushtet dhe të drejtat e shfrytëzimit të këtij ligji në qytetin e Tetovës

1. Sipas rezultateve të hulumtimit tonë, 69% e të anketuarve nuk njihen aspak me ekzistencën e një shërbimi si NJP për qytetarët. Pyetjes se sa prej tyre do të dinin ta shfrytëzojnë këtë mundësi, vetëm 18% i janë përgjigjur pozitivisht.
2. Vetëm 3% e të anketuarve dinë për organizatat e autorizuara për dhënie të NJP-së në qytetin e tyre. Nga 18% e qytetarëve që njihnin NJP, vetëm 3% kanë shtruar kërkesë deri te Ministria e Drejtësisë edhe atë për çështje të sigurimit dhe marrëdhënieve të punës.
3. Deri më 2016,, kur edhe është dhënë raporti i fundit nga ministria, numri i kërkesave arrin deri në 742 në gjithë territorin e Maqedonisë.

4. Nëse krahasojmë me zona të caktuara, mund të shihet dallimi i komunave të ndryshme në kërkesat për NJP. P.sh. mund të shihet diferenca mes Kumanovës dhe Gostivarit, ku në këtë të fundit nuk ka as edhe një kërkesë të vetme për NJP që nga lëshimi i ligjit në zbatim.

5. Një nga shkaqet e numrit të vogël të kërkesave për NJP, është ndalesa e gjithanshme për promovim të organizatave që e ofrojnë këtë lloj ndihme.



Rekomandimet e dala nga anketa e realizuar për njohje të NJP-së dhe kushteve e procedurave për shfrytëzimin e saj në qytetin e Tetovës

- 1) Të gjendet mënyrë për promovimin e NJP-së që të mundin qytetarët të njihen me kushtet e realizimit të kësaj ndihme.
- 2) T'u jepet mundësi organizatave të autorizuara për dhënie të NJP-së, që të shfrytëzojnë mjetet e komunikimit për promovimin e NJP-së, të informojnë qytetarët, sidomos kategorite e ndihme që kanë nevojë për ndihmën, madje edhe nëse ka nevojë nëpërmjet të organizimit të debateve me qëllim informues për ligjin, për mënyrat dhe kushtet e realizimit të ndihmës si dhe për organet kompetente të cilëve mund t'u drejtohen.
- 3) Ministria dhe departamentet e saj të autorizuara për pranim të kërkesave, duhet që të shfrytëzojnë ueb faqet dhe portalet për promovim të ligjit. Gjithashtu duhet të japin informacione nëpërmjet personave të autorizuar të cilët do të mund të jepnin përgjigje të sakta në pyetjet e qytetarëve.
- 4) Ka nevojë për ndryshime thelbësore të vetë ligjit, sidomos në pjesën e kushteve të domosdoshme që duhet të plotësohen nga kërkuesit. Këto kushte janë shumë rigorozë dhe një numër imadh i qytetarëve ngurrojnë të kërkojnë ndihmë edhe kur kanë nevoje, vetëm nga shkak i konditave të cilat janë të përcaktuara rreptësisht dhe të pathyeshme në asnjë përjashtim eventual. Nëse një kusht nuk plotësohet, automatikisht të refuzohet kërkesa për NJP duke lënë shpenzimet e pambuluara, gjatë përgatitjes së kërkesës nga ana e qytetarëve.
- 5) Institucionet, sidomos ato gjyqësore, duhet t'u japin përparësi rasteve nga NJP, duke marrë parasysh rrethanat dhe gjendjen momentale të lëndës, duke pasur në kujdes urgjencën e rasteve të tilla që në ligjin për ndihmë juridike pa pagesë është e paraparë që të bëhen edhe përjashtime, në kontekst të procedurave dhe pritjes.

Përfundimet e dala nga target grupi i shoqatave të regjistruara për të dhënë ndihmë juridike paraprake

Edhe pas 8 vjetësh nga miratimi I LNJP-së dhe pas 7 vjetësh nga zbatimi I tij, ende ballafaqohemi me problem bazike të cilat kanë qenë të pranishme që nga miratimi I ligjit. Implementimi edhe nuk është në atë nivel që të mund të thuhet se është tërësisht funksional.

Konkluzionet që përfshijnë zbatimin e ligjit për ndihmë juridike pa pagesë janë:

1. 8 vjet pas miratimit, numri I kërkesave për NJP nuk ka arritur as deri në 1000 gjatë gjithë kësaj periudhe, në komuna me 25% të popullates së papunësuar dhe të regjistruar si raste sociale.
2. Po përballemi me huti rreth ligjit për shkak se në disa aspekte është shumë I paqartë dhe nuk ka të dhëna shtesë për sqarim.
3. Kërkesat edhe pse të vogla në numër, shpesh refuzohen për arsye të ndryshme madje edhe banale.
4. Organizatat që tani janë në numër pak më të madh nga koha e miratimit të ligjit, (janë të regjistruara diku rreth 10 organizata në gjithë Maqedoninë), nuk fitojnë asnjë ndihmë ose përkrahje nga shteti për shpenzimet që dalin gjatë dhënies së ndihmës juridike pa pagesë dhe ndoshta kjo është edhe arsyeja se pse shumë organizata nuk regjistrohen si dhënëse të NJP-së.
5. Buxheti I mjeteve, në vend se të zvogëlohet nga viti në vit, duhet të shfrytëzohet për segmente të tjera të cilat gjithsesi nuk duhet të dalin jashtë sferës së NJP-së.
6. 7 vjet nga implementimi I LNJP-së është i shoqëruar edhe sot e kësaj dite nga mosinformimi I popullatës për ekzistencën e të njëjtit, sepse Ministria e Drejtësisë nuk I jep rëndësinë e duhur promovimit edhe pse ligji e parasheh një gjë të tillë, duke potencuar se ministria duhet të bëjë ripërtrirjen e ueb-faqes në çdo 6 muaj, ndërkaq realisht informacionet e fundit në regjistrin e avokatëve si dhënës të NJP-së figurojnë nga viti 2012 me 214 avokatë të evidentuar.

Rekomandime të dala nga target grupi i shoqatave të regjistruara për të dhënë ndihmë juridike paraprake

1. Përfshirje më e gjerë e çështjeve ligjore për të cilat mund të miratohet kërkesa dhe të zbuten kushtet që duhet të plotësojë kërkuesi I ndihmës juridike pa pagesë
Të drejtat e qytetarëve duhet të jenë tërësisht të përshkruara në përfshirjen e NJP-së me qëllim të gjithëpërfshirjes së barabartë në ligj. Përveç kësaj, në vend se të jenë fusha juridike



taksativisht të përcaktuara dhe të kufizuara, duhet të jenë përfshirëse në të gjitha çështjet që I tangojnë qytetarët. Nevojitet edhe lehtësim i kushtjeve për arritje deri te NJP.

2. Shpenzimet duhet të përfshihen në të drejtën për NJP.

Nga praktika e deritanishme, shohim se është domosdoshmëri që shpenzimet të jenë të mbuluara si pjesë e të drejtës për NJP.

3. Zgjerim I përfshirjes së NJP-së paraprake dhe financimit të punës së organizatave. NJP paraprake që organizatat dhe ministria e japin në shabllonet e sistemit të drejtësisë që janë objekt i analizave krahasuese, përkrah këshillave juridike dhe mbushjes së kërkesave të NJP, duhet të inkuadrojë dhe shkrime me përmbajtje drejtuese për procedurat. Financimi i avancuar, i organizatave është mekanizmi më I mire për qëndrueshmëri dhe mbarëvajtje të punës.

4. Decentralizimi i vendimeve pas kërkesave për NJP

Decentralizimi është kyç, kur bëhet fjalë për afate të shkurtra që duhet të arrihen dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qasja më e madhe në procedura që do të zmadhojë sigurimin juridik të qytetarëve.

5. LNJP domosdoshmërisht duhet të jetë në pajtueshmëri me ligjet e tjera me të cilët është I lidhur. LNJP është pjesë e sistemit të drejtësisë së RM dhe mund të jetë tëerësisht I implementuar vetëm në qoftë se është në pajtueshmëri me të gjitha ligjet dhe procedurat e tjera, mes të cilëve është ngushtësisht I lidhur me: ligjin për procedura financiare, ligjin për procedura kriminale dhe ligjin për notarizim.

6. Formimi i një organi të pavarur dhe vlerësimi I implementimit të LNJP-së.

7. Element kyç që duhet të përfshihet në reformat e LNJP-së, është formimi I një organi të pavarur që do të garantojë qasje të barabarta në drejtësi për të gjithë qytetarët dhe do të vendosë në shkallë të dytë për ankesat e bëra rreth vendimeve të marra si dhe do tI ketë përfshirje tjera ligjore në juridiksion, të parapara në dokumentin e mëposhtëm.

Literatura e shfrytëzuar


1. Ligji për ndihmë juridike pa pagesë
2. D-r Stojanka Mirceca dhe m-r Ardit Memeti, Анализа и аопфатот на Законот за бесплатна правна помош: еднаков пристап до правдата, OSCE, Shkup, 2010;
3. Годишен извештај за примената на Законот за бесплатна правна помош за 2011 година, Ministria e drejtësis në R.M, Shkup, viti 2011.
4. Годишен извештај за примената на Законот за бесплатна правна помош за 2012, Ministria e drejtësis së R.M, Shkup, viti 2012.
5. Годишен извештај за примената на Законот за бесплатна правна помош за 2013, година, Ministria e drejtësis së R.M, Shkup, viti 2013.
6. Годишен извештај за примената на Законот за бесплатна правна помош за 2014 година, Ministria e drejtësis së R.M, Shkup, viti 2014.
7. Годишен извештај за примената на Законот за бесплатна правна помош за 2015 година, Ministria e drejtësis së R.M, Shkup, viti 2015.
8. Годишен извештај за примената на Законот за бесплатна правна помош за 2016 година, Ministria e drejtësis së R.M, Shkup, viti 2016.
9. Zharko Naxhi – Zafirov, Goce Kocovski dhe Emir Pracanoviq, Бајка или реалност?! – Бесплатната правна помош во Република Македонија, MZMP, Shkup, 2012;
10. Dan Manning, Civil legal aid in the Western Balkans: Achievements, Opportunities and Risks, PILnet, 2012;
11. Пристап до правда во Македонија, Проект за унапредување и промовирање на правото на бесплатна правна помош 2016
12. Мислење за предлог-законот за изменување и дополнување на Законот за бесплатна правна помош 2013 – Ministria e drejtësisë




Aneks 1

Të dhëna nga anketa e realizuar me 500 qytetarë të Tetovës

Pyetja 1




Pyetja 2




Pyetja 3

A dini për ekzistencën e Ndhmës juridike pa pagesë?



Pyetja 4


Nëse përgjigja është po, a e dini se këtë shërbim mund ta shfrytëzoni edhe ju?






Pyetja 5

A e dini cilat Shoqata nga qyteti juaj janë të autorizuara për të ofruar NJPP?




Pyetja 6

A keni dërguar kërkesë për ndihmë juridike pa pagesë deri tani?



Pyetja 7

Nëse përgjigja është po, në lidhje me çfarë ishte kërkesa?



Pyetja 8

A mendoni ju se shteti u jep qasje efikase dhe efektive deri tek e drejta personale të cilët konsiderohen si raste sociale?

